



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 11.11.2020, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla e N- 506

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Shkëmb Manaj, Rasim Demiri, Dimal Basha, Artan Abrashi, Alban Hyseni, Visar Hoti, Evgjëni Thaçi-Dragusha dhe Donika Kadaj- Bujupi.

Munguan: Abelard Tahiri, Endrit Shala dhe Ljubinko Karaxhiq.

Mbledhjen e kryesoi: Shkëmb Manaj, kryetar i komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Alba Hundozi, SKV, Agon Dreshaj, asistent, Liridon Salihu, GLPS dhe Fitore Berisha, Ekonomia Online.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Propozimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Intervistimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtar të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës;
4. Të ndryshme.

1. Propozimi dhe miratimi i rendit të ditës

Rendi i u miratua pa ndryshime.

2. Intervistimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari, tha se po nisim me intervistimin e kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe bëri të ditur se mediat gjatë intervistës së kandidatëve nuk mund të jenë të jenë të pranishme, por vetëm të marrin pamje në fillim. Ndërkohë, që mund të jenë pranishme gjatë pikave të tjera të rendit të ditës. Intervista për anëtar të Këshillit Gjyqësor është zhvilluar njëherë, por është anuluar më pas sepse njëri nga kandidatët nuk i kishte plotësuar kriteret e konkursit.

Në këtë konkurs, konkuruan 7 kandidatë, 3 prej tyre nuk u ftuan në intervistë, për shkak se vinin nga radhët e komunitetit shumicë, shqiptar dhe konkursi ishte për një anëtar nga radhët e komuniteteve tjera.

Komisioni filloi procesin e intervistimit, ku secilit kandidat iu parashtruan nga 3 pyetje nga anëtarët e komisionit. Pyetjen e parë e parashtroi kryetari i komisionit, ndërsa dy pyetjet tjera i parashtruan anëtarët e komisionit sipas radhës.

Nga 4 kandidat të intervistuar dhe duke bazuar në vlerësimin e anëtarëve të komisionit, rezultoi se Sadeta Fazlji dhe Ahmet Imami ishin kandidatët më të poentuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 4, nënparagrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Dimal Basha, propozoi, që të rivlerësohet edhe njëherë poentimi i kandidatëve sepse pati diskutime nga anëtarët e komisionit në lidhje me vlerësimin e kandidatëve.

Pas diskutimeve kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Dimal Basha, me ç'rast u konstatua se me 4 vota për dhe 4 vota kundër, nuk kaloi propozimi i deputetit Basha..

Komisioni, pas përfundimit të procedurës së intervistimit, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I. I rekomandohen Kuvendit për votim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit, si vijon:

1. Sadeta Fazlji - 69 pikë,
2. Ahmet Imami - 66 pikë.

II. Kuvendi, prej 2 (dy) kandidatëve të propozuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të zgjedhë 1 (një) prej tyre.

III. Votimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, bëhet me votim të fshehtë.

Pikat e radhës të rendit të ditës, u shtyn për mbledhjen e radhës të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Shkëmb Manaj,

Kryetari i Komisionit
